

VENDIM
Nr. 10, datë 10.1.2020

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2020, MIRATUAR PËR
BASHKINË TIRANË DHE MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE PËR INSPEKTIMIN DHE
VLERËSIMIN E DËMEVE NË NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE TË
PREKURA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, si dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkisë Tiranë, për inspektimin dhe vlerësimin e thelluar të dëmeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në buxhetin e saj të miratuar për vitin 2020, i shtohet fondi prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh.

2. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e thelluar të dëmeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019, i shtohet fondi prej 160 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekësh, në formën e transfertës në artikullin 604, për Institutin e Ndërtimit, sipas kërkesave për bashkitë e tjera të lidhjes nr. 1.

3. Vlera prej 360 000 000 (treqind e gjashtëdhjetë milionë) lekësh, e parashikuar në pikat 1 e 2, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi për rindërtimin, i miratuar në buxhetin e vitit 2020.

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave për lëvrimin e fondeve në zbatim të këtij vendimi, të dhëna për këtë qëllim, kthehen në buxhetin e shtetit në zërin “Fondi i rindërtimit”.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas lidhjes nr. 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LIDHJE NR. 1

Tabela me përmbajtjen e kërkesave të bashkive për inspektim të thelluar të pallateve dhe ndërtesave individuale

Nr.	Bashkia	Pallate	Banesa individuale
1	Tiranë	448	548
2	Durrës	62	557
3	Kavajë	25	30
4	Shijak	30	550
5	Vorë	20	596
6	Kamzë	12	150
7	Krujë	93	1500
8	Kurbin	58	401
9	Lezhë	14	214
10	Mirditë	2	77
	TOTALI	739	4593